REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 327/22
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 29.12.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Caktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 12 paragrafi 2 shkronja "d" si dhe nenit 13 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur **më 29 dhjetor 2022** merr këtë:

# V E N D I M
## Për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2023

**1.** Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2023.

**2.** Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

**3.** Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2023.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KOMUNA VUSHTRRI**

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Komuna e Vushtrrisë, bazuar në neni 13 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/l-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, publikon;

**LISTËN E VEÇANTË TË PRONAVE KOMUNALE** që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2023, (këto prona duhet të harmonizohen me PZHK-në 2016 - 2024, pastaj të zhvillohen procedurat për dhënien në shfrytëzim konform ligjit).

| | Numri i parcelës | Zona Katastrale | Titullari-Pronari | Sipërfaqja m² | Qëllimi | periudha kohore per dhënien në shfrytëzim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 586-0 | Novolan | Komuna Vushtrri | 25832 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 2 | 529-0 | Novolan | Komuna Vushtrri | 15761 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 3 | 1096-0 | Novolan | Komuna Vushtrri | 2100 | Sipas PZHK-së 2017-2024 | |
| 4 | 366-1 | Prelluzhë | Komuna Vushtrri | 25436 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 5 | 37-0 | Strovc | Komuna Vushtrri | 54774 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 7 | 51-0 | Kollë | Komuna Vushtrri | 100543 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 8 | 337-0 | Kollë | Komuna Vushtrri | 55449 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 9 | 699-0 | Kollë | Komuna Vushtrri | 23272 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 10 | 431-0 | Dumnicë e Llugës | Komuna Vushtrri | 101525 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 11 | 412-1 | Stanovc I Poshtëm | Komuna Vushtrri | 35232 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 12 | 412-4 | Stanovc I Poshtëm | Komuna Vushtrri | 6211 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 13 | 79K-2 | Sllatinë | Komuna Vushtrri | 14126 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 14 | K106-1 | Qytezë | Komuna Vushtrri | 1002 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 15 | 789-0 | Bukosh | Komuna Vushtrri | 28502 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 16 | 474-0 | Liqen | Komuna Vushtrri | 29693 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 17 | 482-0 | Liqen | Komuna Vushtrri | 39838 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 18 | 483-0 | Liqen | Komuna Vushtrri | 13638 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 19 | 435-27 | Lummadh | Komuna Vushtrri | 2000 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 20 | 912-0 | Pasomë | Komuna Vushtrri | 39631 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 21 | 343-0 | Akrashticë | Komuna Vushtrri | 87873 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 22 | 508-1 | Maxhunaj | Komuna Vushtrri | 1065 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 23 | 461-0 | Shtitaricë | Komuna Vushtrri | 11379 | Sipas PZHK-së 2016-2024 | |
| 24 | | | | | | |
| 25 | | | | | | |
| 26 | | | | | | |

***KIOSKAT NË QENDER TË QYTETIT (Shfrytezim deri 10 vite)***

**KIOSKA NR. 1** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 2** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 3** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 4** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 5** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 6** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 7** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 8** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 9** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 10** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 11** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 12** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 13** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

**KIOSKA NR. 14** LLOJI I KIOSKËS-OBJEKT I PERKOHSHEM

LOKACIONI I KIOSKËS- SHESHI "HASAN PRISHTINA", SIPERFAQJA E KIOSKUT: 12 m²

PARCELA- 00653-0

REPUBLIKA KOSOVO • KOMUNA E PRISHTINËS • DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRËS • REPUBLIKA KOSOVO • OPSTINA PRIŠTINA • UPRAVA ZA GEODEZIJU I KATASTAR

Drejtori i Drejtorisë

Remzi Ahmeti

01 Nr./Br 328/22
Nr. Fq./Br. st. -1-
Data/Datum 29.12.2022

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 7 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër komunal Nr. 04/L-010 (Gazeta Zyrtare e Republikës Nr. 7/10 Gusht 2011), nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **29 dhjetor 2022** merr këtë:

**V E N D I M**
**Për miratimin e nismës për bashkëpunim ndërkomunal**

**1.** Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë 02Nr.1618/22 datë 07.12.2022 për bashkëpunim ndër komunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Skënderajt.

**2.** Autorizohet Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që pas konsultimeve me Kryetarin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Skënderajt të përgatis Draft Marrëveshjen e Mirëkuptimit për menaxhimin e integruar të mbeturinave për këto tri komuna.

**3.** Draft marrëveshja e hartuar në tekstin final, i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim bazuar në procedurat e caktuara ligjore.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 329/22
Nr. i fq. / Br. st - 1 -
Data: / Datum: 29. 12. 2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 pika "d" nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 13, paragrafi 2, pika1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në seancën e mbajtur më **29 dhjetor 2022** merr këtë:

**VENDIM**
**Për shfuqizimin e Vendimit 01Nr.236/20, dt.26.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq- Dega në Vushtrri**

1. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi 01.Nr.236/20, dt.26.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq-Dega në Vushtrri, në pjesë të parcelës kadastrale P-K4103-1, në sipërfaqe prej 250 m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5696 m2, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Kooperativa Bujqësore në Vushtrrisë.

2.Me këtë vendim njoftohen Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenë Sociale, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.

3.Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**

01 Nr. / Br. 330/22
Nr. Fq. / Br. st. -1-
Data / Datum 29.12.2022

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008, nenin 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **29 dhjetor 2022** merr këtë:

# V E N D I M
## për ndryshim dhe plotësim të vendimit

**1.** Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.192/22, dt. 28.07.2022, pika 2 e vendimit dhe formulohet me tekst si në vijim: **"Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të vendimit bazë do të merren nga buxheti i zyrës së kryetarit të komunës, kategoria subvencione dhe transfere, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve do të sigurohen nga participimi i qytetarëve të atij lokaliteti".**

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të komunës.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**